



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**

---

Numri i lëndës: 2018:017990  
Datë: 24.04.2019  
Numri i dokumentit: 00288824

**P.nr.1096/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit, A. K., për shkak të veprës penale nga neni 80 par 1 të Ligjit për minierat dhe mineralet, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 2363/2017, të dt. 24.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të dt. 16.04.2019, në prezencë të Prokurorit të shtetit Suada Hamza, të pandehurit A. K., mbrojtësit të pandehurit av. Dritëro Kollçaku, përfaqësuesit të palës së dëmtuar të KPMM-së -E. XH., me date 16.04.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me date 23.04.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**A. K., i biri i XH. dhe nënës SH., e gjinisë G., i lindur me dt. ..., në Pejë, me vendbanim në fsh. .... K-Peje, me profesion transportues zhavorri, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, identifikuar në bazë të lnj. nr. personal ....., i gjendjes së dobët ekonomike, posedon këtë numër telefoni ....., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse,**

Me pare e gjere me dt. 21.07.2017 në fsh. ... K- Pejë, me dashje dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Minierat si dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163, ka bere degradimin e tokës dhe ka shfrytëzuar jashtë mase burimet natyrore, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit të Inspektoratit të Minierave të KPMM- së, kanë konstatuar se i

pandehura ka ushtruar aktivitet te jashtëligjshëm mineralar ne përpunimin e resurseve minerale te rërës dhe zhavorrit pa leje për aktivitet te veçante – Seperacioni te resurseve minerale për te cilat nuk posedonte Licence te shfrytëzimit duke krijuar kështu stoqe te rërës dhe zhavorrit te pastruara dhe seperuara, ku sasia e mineraleve te shfrytëzuara arrin 258.10 m3,

- Me çka ka kryer vepër penale nga neni 80 par 1 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,47,73, të KPK-së, nenit 80 par 1 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin:

## **E G J Y K O N**

Me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Konform nenit 47 të KPRK-së me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burg, në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, i zëvendësohet me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 800,00 (tetëqind) €, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej 2 (dy) muaj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri refuzon që ta paguajë gjobën, ose nuk e paguan gjobën në tërësi, atëherë, i njëjti do të dërgohet në vuajtje të dënimit të përcaktuar më lartë.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara KPMM e Republikës se Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 2363/2017, të dt. 24.10.2017, kundër të pandehurit A.K., për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 1 te KPRK-së.

Me 16.04.2019, është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit Suada Hamza, i pandehuri A.K., mbrojtësi i te pandehurit av. Dritëro Kollçaku, dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar të KPMM-së -E. XH..

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohe për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, pa presion nga askush.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, e meqenëse një pranim nga ana e tij është i bazuar edhe në provat tjera në bazë të cilave është ngritur aktakuza, prokurorit të shtetit nuk i mbetet asgjë tjetër, dhe mbetet në tërësi pranë aktakuzës, përshkrimin, faktit juridik të veprës penale, i propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim i propozon gjykatës si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës se dëmtuar KPMM- së, E.XH. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurores në tërësi dhe e parashton kërkesën pasurore juridike.

Mbrojtësi i te pandehurit, av. Dritëro Kollçaku në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana te pandehurit , i cili pranim është bërë pas konsultimit paraprak që e kishin pas në mes veti, dhe pasi të njëjtit paraprakisht ia ka shpjeguar të mirat dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ashtu që e mbështet pranimin e fajësisë. S rrethane lehtësuese mbrojtësi i te pandehurit propozoj te merret fakti se i pandehuri eshët hera e pare qe ka rëne ndesh me ligjin , shkallen e ulet te përgjegjësisë penale pasi rikualifikimi i veprës penale të bere nga prokurorja e shtetit pasi qe për këtë vepër parashihet dënimi me burgim deri ne 6 muaj, moshën e re te mbrojturit te tij si dhe për te njëjtën arsye është dënuar ne procedure administrative me dënim me gjobe , andaj i propozon gjykatës qe te njëjtit ti shqiptohet vërejtje gjyqësore, e cila parashihet për veprat penale deri ne një vit dhe se këtë sanksion alternativ i pandehuri do te merr si qortim nga ana e gjykatës dhe nuk do te përsërisë këtë vepër penale.

I akuzuari A. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalët e mbrojtësit te tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi qe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza siç janë: deklarata e te pandehurit A.K. e dhënë me dt. 19.10.2017 ne Stacionin policor ne Pejë, raporti i Inspektimit te aktiviteteve te jashtëligjshme minerare i dt. 27.07.2017, urdhëresa për ndërprerjen e aktiviteteve

te jashtëligjshme minerare dhe sekuestrimin e mjeteve te punës dhe mineraleve, raporti mbi kalkulimin e vëllimit i dt. 02.08.2017, raporti për operim ilegal i dt. 26.09.2017, si dhe foto dokumentacioni shkresa tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A. K., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, 80 par 1 i Ligjit për Minierat dhe Mineralet

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, gjatë shqyrtimit gjyqësor, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer, si dhe faktin se i pandehuri me pare nuk ka qene i dënuar dhe nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale, për paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.1096/17, dt. 23.04.2019**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

---

Selvane Bukleta

**GJYQTARI**

---

Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.